

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS** – koleji i përberë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Kompania e Sigurimeve ‘.....’ sh.a nga P., kundër të paditurit Autoriteti Kosovarë i Konkurrencës (AKK), për shkak të anulimit të vendimit e të paditurit nr. ...., datë ....., lidhur me kërkesën e të paditurit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, AA-UZH nr.501/2017 datë 23.01.2018, në seancën e mbajtur më 10.05.2018, mori këtë

### **A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e të paditurit Autoriteti Kosovarë i Konkurrencës, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.501/2017 dt.23.01.2018.

### **A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA.UZH. nr.501/2017 dt. 23.01.2018 është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurit Autoriti Kosovarë i Konkurrencës (AKK), paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dep.administrativ, A-U nr. 2416/2014 datë 07.09.2017, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpapia e paditësit për anulimin e vendimit e të paditurit- ..... dt..... dhe paditësi është liruar nga sanksioni administrativ prej 100.000,- Euro (njëqindmijë euro).

I padituri i ka paraqitur kësaj gjykate kërkesë për rishqyrtim të vendimit gjyqësor, me të cilën konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur, duke theksuar se aktgjykimi i kontestuar është marrë me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe të dispozitave procedurale, duke propozuar që të aprovohet kërkesa, të anulohet aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit AA. UZH. nr.501/2017 dt. 23.01.2018, dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme mbajti seancën në përputhje me nenin 53 të LKA, ekzaminoi aktgjykimin e kontestuar, vlerësoi pretendimet e paraqitur në kërkesë dhe, pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës konstatoi:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshme të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.UZH. nr.501/2017 dt. 23.01.2018 është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurit AKK, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Dep.administrativ A.U.nr.2416/2014 dt.07.09.2017, me të cilin është aprovuar kërkespadija e paditësit për anulim të vendimit e të paditurit – ..... dt.....

Neni 3.1 i Ligjit për Konkurrencën përcakton se marrëveshja ndërmjet ndërmarrjeve, vendimi i një shoqate të ndërmarrjeve ose një praktikë e bashkërenduar e ndërmarrjeve është e ndaluar nëse (i) mund të ndikon në tregtinë brenda Kosovës, (ii) ka për qëllim të saj ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konkurrencës në Kosovë, dhe (iii) zbatohet ose ka për qëllim të zbatohet në Kosovë. Ndalimi nga ky nen vlen njëjloj për të gjitha marrëveshjet, vendimet dhe praktikat, qoftë ato të shkruara apo jo. Duke vlerësuar gjendjen faktike nga shkresat e lëndës, gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë bërë vlerësimin e validitetit të marrëveshjes së lidhur mes përfaqësuesve të kompanive të sigurimeve, dhe kanë konstatuar se marrëveshja e dorëzuar si dokument i fotokopjuar nuk mund të konsiderohet si provë relevante. Marrëveshja nuk përmban ndonjë vulë të kompanisë që pretendohet të këtë nënshkruar Marrëveshjen. Poashtu, gjykatat kanë vërejtur se dokumenti nuk posedon as ndonjë numër të protokollit. I padituri nuk ka mundur të vërtetojë faktet se nënshkruer i marrëveshjes së datës ..... ka qenë njëri nga punëtorët e autorizuar të paditësit. Kjo Gjykatë konsideron se këto elemente të analizuar lidhur me origjinalitetin e Marrëveshjes vëjnë në pah mangësi serioze për të konsideruar një marrëveshje të tillë si dokument origjinal dhe autentik. Përveç kësaj, kjo Gjykatë konsideron si të drejt konstatimin e të dy gjykatave se i padituri nuk ka mundur të provojë pretendimet e tij në gjykatë, se përfaqësuesit e paditësit kanë nënshkruar marrëveshjen e kontestuar të datës ..... të lidhur në Gj. dhe se i njëjti është përgjegjës në kufizimin dhe çrregullimin e konkurrencës së lirë në treg që do të binte ndesh me ligj. Prandaj, kjo Gjykatë gjen se gjykatat e instancave më të ulëta drejt kanë vendosur kur janë bazuar në dispozitat e Ligjit për Konkurrencën 2004/36, dhe se vendimi i të paditurit nr. .... dt..... është vendim i kundërligjshëm dhe paditësi lirohet nga sanksioni administrativ prej 100.000,- euro (njëqindmijë euro) i shqiptur nga i padituri.

Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se pohimet në kërkesën e të paditurit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm janë të pabazuara sepse ato nuk ndikojnë në vërtetimin tjetër të gjendjes faktike nga ajo që ka vërtetuar gjykata e shkallës së dytë. Aktgjykimi i shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm, përmban arsye faktike dhe juridike për të gjitha faktet vendimtare. Gjykata Supreme vlerëson se e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe se ligji nuk është shkelur në dëm të paditësit.

Nga sa u parashtrua dhe në bazë të nenit 54 par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
ARJ-UZVP nr. 37/2018 datë 10.05.2018

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit  
Nebojsa Boriçiq,

Përktheu,  
F. A.